

Re: Kerkoj informacin

From info <info@dpm.gov.al>

Date Wed 17/12/2025

To

Përshëndetje,

Në përgjigje të e-mail-it tuaj, më datë 11.12.2025 "Kërkesë për informacion", protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme e Metrologjisë me nr. 2797 prot., datë 11.12.2025, Ju bëjmë me dije si më poshtë.

Një ndër detyrat dhe kompetencat e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë (DPM) është edhe verifikimi i instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluara, ndër të tjera edhe taksimetrat.

Ky shërbim kryhet në mbështetje dhe zbatim të:

- Ligjit nr. 126, datë 15.10.2020 "Për Metrologjinë", i ndryshuar;
- Urdhrit të Ministrit të MFE nr. 219, datë 21.09.2022 "Për miratimin e rregullores së verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar", i cili përcakton se afati (intervali) i detyrueshëm i verifikimit periodik është çdo 12 muaj;
- Udhëzimit të Përbashkët nr. 2, datë 08.02.2013 të Ministrit të Financave dhe Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE) "Për tarifat dhe pagesat e shërbimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë", konkretisht, për taksimetrat përcakton një tarifë verifikimi prej 2 500 lek (pa TVSH) për copë, pra për 1 (një) taksimetër.

Shërbimi i verifikimit të instrumenteve matëse ligjërisht të kontrolluar, konkretisht taksimetër, ofrohet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, përmes Sektorëve të Shërbimeve, tek të cilët mund të drejtoheni për të marrë shërbim, referuar vendndodhjes së aktivitetit tuaj.

Për instrumentin matës, taksimetër, DPM-ja ka kompetencë vetëm verifikimin e tyre, i cili kryhet referuar bazës ligjore të sipërcituar, ndërsa tregtimi i taksimetrave dhe instalimi i tyre në taksi nuk kryhet nga DPM-ja, por nga subjekte private, ushtrimi i aktivitetit të të cilëve nuk rregullohet dhe nuk varet nga DPM-ja.

Referuar legjislacionit për metrologjinë, instrumentet matëse, përfshirë edhe taksimetrat, vendosen në treg dhe/ose vihen në përdorim nëse kanë markimin CE, Markimin Metrologjik Suplementar M dhe dy shifrat e fundit të vitit të prodhimit të rrethuara nga një drejtkëndësh, lartësia e të cilit është e njëjtë me lartësinë e markimit CE; numrin unik të trupës notifikuese që ka marrë pjesë në fazën e kontrollit të prodhimit, i cili vendoset nga vetë trupa ose, sipas udhëzimeve të tij, nga prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i

autorizuar, nëpërmjet së cilës prodhuesi, përfaqësuesi i autorizuar ose importuesi garanton se instrumenti matës është në përputhje me kërkesat metrologjike të përshkruara.

Duke ju falenderuar,



Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë
Autostrada Tiranë-Durrës, km 8
1001 Tiranë, Shqipëri
E-mail: info@dpm.gov.al
web: www.dpm.gov.al